



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060-72005 dt. 20.12 2019

Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
29. 11.2019

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 29.11.2019

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 30 anëtarë .

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 30.10.2019.
2. Propozim Vendim për ndryshimin e periudhës së zbatimit të PLVM-së për vitet 2020-2024.
3. Propozim Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2020-2024
4. Propozim Vendim lejohet vazhdimi i kontratave me qira joprofitabile mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të banesave sociale në Bllokun e banimit I dhe II-të në Drenasin III.
5. Propozim Vendim për lëshimin në shfrytëzim afatgjatë të parcelës në ngastrën kadastrale në Komoran për ndërtimin e një objekti në shfrytëzim nga ana e Komunitetit.
6. Propozim Vendim për lëshimin në shfrytëzim afatgjatë të parcelës në ngastrën kadastrale në Sankoc për ndërtimin e një objekti në shfrytëzim nga ana e Komunitetit.
7. Propozim Vendim për harmonizimin dhe transferin e mjeteve për paga.
8. Propozim Rregullore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2020.
9. Propozim Vendim për mbështetje financiare qyteteve të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në Republikën e Shqipërisë.
10. Propozim Vendim për ndryshim të anëtarëve të KKSB-së.
11. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 29 /11/ 2019 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Kryesuesi Labinot Halilaj, përfaqësues të KDI-së, përfaqësues të OSCE-së, si dhe drejtor të Drejtorive përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj- Përshëndetje të gjithëve! Konstatoj se prezent në mbledhje janë 30 pjesëmarrës. Hap diskutimet për rendin e ditës dhe ju njoftoj se kryetari Komunës ka dy pika shtesë të rendit të ditës: - Propozim Vendim për mbështetje financiare qyteteve të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në Republikën e Shqipërisë, dhe - Propozim Vendim për ndryshim të anëtarëve të KKS-së. Kërkoj nga anëtarët e kuvendit se a pajtoheni me këtë rend dite, apo ka ndonjë propozim? Jo. Meqenëse nuk ka diskutime, vërejtje apo sugjerime kalojmë në votimin e Rendit të ditës, votojmë;

*Për votuan 30 anëtar,
Kundër s'ka
Abstenim s'ka. Miratohet.*

Hapim diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 30. 10. 2019. Diskutime, vërejtje apo sugjerime, nuk ka. Kalojmë në votim, votojmë prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar:

*Për votuan 30 anëtar
Kundër s'ka
Abstenim s'ka.*

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj; Hapim diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:
2. Propozim Vendim për ndryshimin e periudhës së zbatimit të PLVM-së për vitet 2020-2024.

Fjalën e mori drejtoresha e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit- Flutura Avdiu

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj; Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar:

*Për votuan 25 anëtar
Kundër votuan 00 anëtar
Abstenim 00 anëtar.*

... zëri nuk dëgjohej deri në minutën e 19... vijon zërat duke folur pa radhë.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj; Zoti Berisha nuk je në rregull. Gjithë kohës je duke fyer. Nëse është dikush që po fyer, ti je duke provokuar, jo filozofi mos bëj, marre turp, fyerje janë, nuk janë komplimente. Faleminderit. Jo jo kaloj kjo. Zoti bylykbashi. Patjetër, Kalo. Po fole po mirë de.

Vehbi Berisha; S'ia ndali fjalën kryetarit se nuk kam të drejtë me ia ndal, por... dëgjo Ramiz Lladrovci! Prej sodit ju e keni dit që i keni këqyr imtësitë e mia, po ngom ngom, veç pak, se tash

kam të drejtën me fol. Ditë e natë hulumto se ti nuk ma ul krenarinë, aq më pak njëërës si ti, se të gjithë të njohin dhe unë më mirë se kushdo tjetër. Jam krenar për të gjithë këtë shërbim që ia kam bërë vendit tim, këto 10 vite që jam në politikë. Jam krenar se jam nga zyrtarët e paktë që i kanë mbijetuar politikës, pa u zhytur në asnjë ujë dhe po të them sinqerisht jo ato llajka por çfarëdo mund me shpif dhe kurrë s'ke me muj me më përku, se për mu flasim veprat flasin punët. Po të mos ishte reagimi im ky vendim kurrë s'do kishte mujt me ndryshu. Ti sot mundesh me thanë çka dush, por reagimi im u ka vu në pah dhe ju hakmarrjen e keni në gjak dhe e keni shantazhin, po ti nuk mund me më shantazhu. Ti di me ba këtë punë veç ma së miri. Ti bëje po me mu s'ke me pas sukses kurrën e kurrës.

Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci; Nëqoftëse se po mendon se po shpifi, se nuk i ke çu drejtoreshës zëmra në fb., fotografi me bikini, atëherë... fotografi të saja, atëherë ju lutem çoje në gjykatë dhe atje e marrim përgjigjen.

Sokol Bylykbashi Veç po du me thënë tri fjalë. Pa dash me hy në detaje se nuk i di, veç po du me fol atë çka unë e di dhe besoj që është shumë e drejtë. Aspektet personale nuk është mirë me i diskutu në aspektin zyrtar dhe politikë është gabim. Kjo është e papranueshme. Është e pa pranueshme dhe kjo është keqpërdorim i punës edhe i Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj; Ky është debat i kotë dhe shumë debat zhvillohet për probleme personale. Po shumë pak debat ka pas për pikat e rendit të ditës, vazhdimisht ka pas shumë pak debate, por kur vjen puna për tema të parëndësishme janë bërë debat... Jo lëre lirisht mund t'ia japësh përgjigjen. Ju ftoj të votoni. Ju faleminderit për debatin. Ju ftoj të votoni. Votojmë tani

**29 votojnë për
Kundër s'ka
Abstenim 1**

Atë herë shkojmë tek **Pika 3. Propozim Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2020-2024.** Prap drejtoresha sqarim.

Drejtoresha e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu; Përpara vetes e keni një projekt vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për vitin 2020-2024. Në vitin 31 janar 2018 është formuar një komision që ka pasur si qëllim hartimin e planit Lokal të Veprimit në Mjedis. Meqenëse plani Lokal të Veprimit në Mjedis ka qenë në përbërje të ekipës dhe në përmbledhje të takimeve konsultative me ekipën është marrë vendim që të formohet një person që do të koordinojë të dhënat për planin Lokal të Veprimit në Mjedis. Duhet theksuar se planin Lokal të Veprimit në Mjedis është edhe indikator i matjes së performancës nga Ministria e Pushtetit Lokal, të cilën çdo komunë duhet ta ketë në mënyrë që të ndikojë në dhënien e granteve për vitet në vijim. Andaj unë ju ftoj që ta miratoni planin Lokal të Veprimit në Mjedis për periudhën 2020 – 2024, plan të cilin komuna nuk e ka pasur për rritjen e performancës dhe si një indikator për matjen e kësaj performance. Theksoj edhe një herë se plani

Lokal të Veprimit në Mjedis për periudhën 2020 – 2024 është hartuar për ti adresuar problemet mjedisore. Është një dokument strategjik që ka për qëllim përmirësimin e jetës për sa i përket cilësisë së mjedisit për të gjithë.

Kryesuesi : Labinot Halilaj Faleminderit Drejtoresh , a ka dikush diqka. Merr fjalën .

Vehbi Berisha; Natyrisht e kemi hulumtu këtë material të draftit të plani Lokal të Veprimit në Mjedis. Kur është bërë plani kemi zgjedhur një komision prej 12-13 anëtarëve dhe ky komision u taku krejt dy herë, me sa mbaj mend unë. Në njërën nga mbledhje nuk kam marrë pjesë, sidomos në mbledhjen e parë që ka qenë mbledhja konstituive dhe mesa di unë Drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës, Idriz Hysenaj u merr me të më shumë dhe më ka pas njoftu që kanë vendos me zgjedh një kompani, e cila bën hartimin e planit.

Unë e kam një pyetje. Qysh u zgjedh kjo kompani? Në bazë të çfarë procedurash e para. E dyta. Unë atë kohë pata propozu që nëpërmes puntorive që do të mbaheshin të premte e të shtune për me mujt me hartu këtë plan me qëllim që kishim kontribu gjithë anëtarët e këtij komisioni. Ne tash e kemi një plan para veti, që ky plan më së pakti është vepër e komisionit, se anëtarët e komisionit nuk kanë pasur mundësi me dhënë kontribut sepse e ka shkru komplet kjo kompani. Tek pjesa fillestare mendoj se duhet me ju bashkangjit vendimi që sapo e miratuam, një kopjo e vendim e skanuar është e udhës që çdo plan me pas kopjon e vendimit të skanuar, me qëllim që me dit se mbi ç'bazë të vendimit po hartohet ky plan, ku atu natyrisht ceken edhe vitet. Periudha e vitit kur do të implementohet ky plan.

Tek çështjet e tjera që e kam pa tek prioritetet që më ka ranë në sy, ka ra tek çështja e ujit. Këta ekspertë që kanë hartuar planin janë thirre në liqenin akumulues të Verbofcit, për me përmirësuar performancën e ujit dhe shtimin e kapacitetit të ujit në Drenas. Përderisa po planifikohet është mire me ditë kapacitetin e burimeve ekzistuese d.m.th ku ka prezantuar këtu burimet e ujit p.sh. në Poklek sa litra ujë në sekondë ka, në Krajkovë sa litra për sekondë kanë këto burime të ujit me qëllim që me dit a mund me mbulu nevojat e qytetarëve, se këtu e ka bërë se jemi mbështetë në kapacitetet e liqenit akumulues. Ti kur bën një plan duhet me dit pak a shumë mbi çka mu bazu dhe kryetari na ka prezantuar, se është bërë një studim atje dhe përderisa është bërë një studim janë bërë analiza se sa është sasia e qëndrueshme e atij burimi.

Tek pjesa tjetër, tek hartimi i prioriteteve këtu që janë shtrirë sipas viteve janë disa çështje si mbrojtja e cilësisë së ajrit. Eksperti ka renditur disa pika të pakta si djegia e thëngjillit. Djegia e thëngjillit ka kohë që është ndalu që prej vendimit që ka marrë Ministria e mjedisit dhe planifikimit mjedisor. Ti kot e shkruan këtu se automatikisht ti duhet me e hjekë se e ke vepër penale nëse e përdor, përderisa është ndalur nga organet kompetente të shtetit. Po ashtu vetëm një masë mu ka duk e drejtë ku thotë zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta në zonën urbane dhe zonat përreth uzinës së Ferro-nikelit. Ajo çka më interesoi është kur është hartu plani nëpër vite. Pse nuk u cek kostoja e përafërt e atij plani qe ka mu implementu. Ndaj mendoj se duhet vënë këtu një kolonë me koston e përafërt për çdo projekt. Ka dhe një marzh që mundet me dal një shtesë etj, pra duhet planifikuar mirë. A është mëndu që taksa që paguhet për sigurimin e automjeteve me qenë si burim i mjeteve. Unë mendoj se ajo taksë që e paguajnë qytetarë duhet të

inkorporohet domosdo se është shumë e domosdoshme dhe e nevojshme. Po ashtu mënyra e hartimit të këtij plani, ndoshta e ka pamundësu dhënien e ideve inovative edhe të anëtarëve të komisionit, që të behet ne menyrë kreative ashtu siç kam kërkuar unë. Këto ishin pyetjet dhe sugjerimet e mia .

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj; Faleminderit . Atëherë a ka diskutues tjerë. Atëherë i thu ti s'ke qenë në mbledhje hiç. Ne të këna ftuar e ti s'ke ardhur në mbledhje. Po fjala për zonja Avdiu.

Flutura Avdiu; Vehbi! Zgjedhja e kompanisë janë mbajtur dy mbledhje dhe në asnjërën nuk ke qenë pjesë. Ne jena kordinu në mbledhje që një ekspert ka me kordinu të dhënat që kanë mbledhur anëtarët e komisionit. Ky plan,... Jo kompania është e kontraktueme me proces të rregullt tenderimi mund ti kontrollosh dokumentacionin ke qasje të lirë gjithçka është transparente. Mirëpo grupi punues ka vendos që mu caktu një ekspert, një kompani, qe me i përpunu të dhënat që ofrojnë grupi. Plani është hartu në bazë të të dhënave të grupit të punës. Pra diçka në këtë formë është vepru. Diçka tjetër këtu nuk ka pas. Kemi shpreh si rekomandim Kompanisë.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj; Faleminderit shume. Pas diskutimeve ju ftoj të votoni.

27 për

1 kundër

2 abstenime, Kalon.

Kalojmë në pikën 4. Propozim Vendim lejohet vazhdimi i kontratave me qira joprofitabile mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të banesave sociale në Bllokun e banimit I dhe II-të në Drenasin III. Hapim diskutimet. Po. Z. Kiqina

Beqir Kiqina. Sa i përket kësaj çështjeje. Unë si anëtar i këtij komisioni për dhënien në shfrytëzim për banim të përkohshëm shprehi dëshirën që të raportoj në këtë kuvend për punën që ka bërë ky komision. Së pari ky komision është i përbërë edhe nga anëtarët e Kuvendit ku në këtë komision kanë marrë pjesë unë Beqir Kiqina së bashku me Elmi Shalën dhe Neim Gjellën si anëtarë të votuar nga ky kuvend. Në këtë komisionin e kanë marrë pjesë anëtarë nga Administrata e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, shoqëria civile si dhe organizata jo qeveritare që merren me banim të përkohshëm dhe në bazë të ligjit për banim të përkohshëm jemi munduar që ti rishikojmë këto raste dhe kemi vendosur tua vazhdojmë kontratën atyre, të cilëve ua përcakton ligji dhe rregulli i udhëzimit administrativ.

Së pari kemi përdorur të gjitha metodat që janë për informim. Ata banues që janë në blloqet e banimit janë informu me kohë nga data 28.06.2019 edhe në web faqen e Komunës, që do të thotë se të gjithë e kanë pasur kohën për aplikim, por janë informu edhe ata që nuk kanë banu aty për me fitu të drejtën. Në këtë kontekst kur bisedojmë është e vërtetë që disave u është vazhdu kontrata dhe disave jo, por kemi të tjerë që janë fitues. E keni këtu materialin përpara ku janë përgatitur nga sekretaria e Kuvendit dhe anëtarët e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale ku shihet se

dikush e ka humbur të drejtën për banim pasi ka bërë zgjidhje për kushtet e banimit. Ka patur raste kur personi ka ardhur dhe ka deklaruar se ka bërë zgjidhje. Ka pasur edhe raste ku banoret kanë shkuar tek të afëmit e vet për arsye se banesat nuk janë më shumë se 62 m², ndërsa më e vogla as sa gjysma e një shtëpie normale. Komisioni e ka bërë punën e vet. Ka dalë në terren kanë verifikuar dhe njoftu për 50 raste ku komuna mundet. Ka pas ndryshime, shikoni se kjo është bërë mbi baza të polenizimit. Një sqarim që dua ta bëj; Ligji për dhënien në shfrytëzim të këtyre banesave specifikon qartë. Paga përpjesëtohet në bazë të anëtarëve të familjes dhe kuptohet për shumë arsye, kemi të dhënat e BKQ etj., sepse kemi pasur kontestime të ndryshme për heqjen e të drejtës për vazhdimin e kontratës mirëpo ligji vendos për drejtën e vazhdimin të kontratës jo ne. E kemi marrë e kemi shqyrtuar këtu dhe kjo ka ardhur përsëri në sqarim. Çfarëdo pyetjesh që të keni mund të drejtoni pasi këtu janë edhe drejtoret përkatës.

Sokol Bylykbashi; Sa i përket përkujdesjes sociale që duhet ti kenë institucionet, në këtë rast, Komuna e Drenasit, për familjet dhe personat që kanë nevojë në aspektin social, të banimit apo financiar Partia LVV ka qenë më e zëshme me ba sa më shumë në këtë drejtim. Mirëpo propozim vendimit i mungon diçka shumë e rëndësishme, I mungon raporti i komisionit. Si mundim ne me marr vendim pa raport. Nuk e di pse nuk ka ardhur raporti ku ne prap mund të diskutojmë për raportin e tyre si edhe sa i përket kritereve dhe metodës së punës që janë zbatuar dhe fakteve që janë në raport që neve na bën me besu. Këta po thonë, në këtë rast Beqja po thotë besoni në fjalë. Unë në fjalë nuk mund me besu. Vëllai im me qenë unë nuk besoj. Na jemi zyrtar të Kuvendit Komunal dhe nëse duhet të besojmë besojmë në dokumente. Kurrkush nuk më ndal me me hetu një familje, normal pa e shkel ligjin. Pa pasur raportin, ne nuk mund të diskutojmë as për metodat dhe as për kriteret e përzgjedhjes të fakteve që i kanë dhe sa peshojnë ato fakte që kanë. Sepse kësaj i thonë, ju merrni vendim se punën e kryejmë ne. Jo kjo nuk shkon. Ai që merr vendim duhet të ketë edhe faktet për të ditur se çfarë po bën. Unë kisha pas qefë me përkrah këtë dokument mirëpo në këto kushte unë votën nuk muj me dhënë. Po besoj edhe si lëvizje.

Nexhmedin Balaj; Faleminderit Kryesues. Unë s'po du me justifiku këtë komision, sepse vota jonë ka qenë prezent dhe ne i kemi besu totalisht këtij komisioni që të kryej punën. Ajo çfarë tha kolegu dhe çfarë është më e ndjeshme që një person me një rrogë të arsimit nuk mundet me ndërtu një shtëpi, më bëni përshtypje që me e hap këtë debat. Atëherë si mundet një me të ardhura sociale me ndërtu një shtëpi, të cilit me siguri ia keni refuzu këtë kërkesë këtij komisioni. Nuk keni në raport sa kërkesa keni refuzu, cilët janë ata që keni refuzu dhe cilët janë ata persona që kanë përfitu vazhdimisht. Nëse vërtetë ata privohen vetëm për dy vjet na brenda dy vjetësh kemi edhe nëpër televizione që na dalin persona me iks me emër e mbiemër dhe nuk kanë shpi mbi kulm dhe janë me ndihma sociale. A kanë bërë kërkesë ata persona dhe ju me çfarë arsye i keni refuzuar. Nëse doni veç me fjalë unë po përdor veç një fjalë: Kam dëgju se ka njerëz që vozisin kerre 10 mijë euro dhe ju e keni sjellë prapë me e votu si komision. E keni marrë votën tonë për me e kry punën siç duhet. Janë rastet vërtetë sociale që duhen trajtuar.

Kryesuesi Labinot Halilaj : Faleminderit fjalën e merr Kryetari z. Lladrofi pastaj z.Gashi.

Kryetar Ramiz Lladrofi : Për sqarim raportit është banë raportit është protokollu, zyra e ju vë nuk i ka dërgua , nuk po thamë a e ka banë me qellim apo pa qellim se njerëzit gabojnë janë gabime. Tash e keni raportin detal ku raportit është protokollu me kohë dhe është drejtuar në 12 tek zyra kuvendit , kështu që e merrni nuk ika fajet komisioni ika fajet zyra e kuvendit ata që po din me punua mirë dhe ata që po janë të mirë , S'podu me paragjykua. Pasi skam drejtën me fol po e jap një **Sqarim :** nga shefja e zyrës së Kuvendit Zahrie Podrimqaku, rreth Raportit të Komisionit: në zyrën e Kuvendit raportit na ka ardhur në ora 9.48, ne e kemi pas kohën e mbledhjes në orën 10⁰⁰. Unë i kam thënë punonjësës time Liridona Berisha me e bërë kopje për kuvend deri sa te vim te pika e katërt, me ka tha se bej për arsye se e kanë prurë me vonës. Pastaj e kam thirr Lumturie Kininën ne telefon dhe i kam than hajde bane kopje me ka thënë jo se është punë e Liridonës, unë kam pas me mbajt procesverbalin mbledhjes dhe mu ka dashtë me qenë në Kuvend.

Petrë Gashi; Edhe unë jam dakort me parafolësit dhe kam një mendim tjetër nëse më lejohej, që kjo të shtyhet për seancën e ardhshme në meny që edhe neve të na jepet mundësia për të verifikuar emrat që njihen si përfitues të banesave sociale, të marrim edhe raportin dhe të shohim njerëzit që janë refuzua, mos ndonjëri prej tyre i ka plotësuar më shumë kërkesat d.m.th kriteret sesa këta që janë përfitues të kësaj, dhe të shihet se mos ka edhe konflikt interesi ose konflikte të brendshme dhe këta emra nuk përkojnë me realitetin të cilin është në teren. Pra kërkoj të shtyhet në seancën e ardhshme në të kundërtën ne nuk mund të votojmë në këtë mënyrë sepse nuk kemi një raport detal që e arsyeton këtë propozim vendim. Faleminderit.

Kryetari i Komun Ramiz Lladrofi; Komisioni thash e ka kryer raportin dhe komisioni i ka marrë krejt ankesat dhe janë shqyrtuar të gjitha ankesat. Kerkush nuk mund me e diskutu diçka, që një komision i ka shqyrtu ankesat. As nuk e di kush i ka fitu, as kush nuk e ka fitu, por këto procedura janë krye dhe nuk mund të shtyhen sepse propozim vendimet nuk këna kohe me i shty. Këtu ka votim **„Për, Kundër, Abstenim**. Nëse ju akordoheni me këtë raport dhe këtë vendim-propozim e votoni kundra pastaj mund të krijohet një komision tjetër krejt të ri dhe vazhdojmë me procedura. Nuk mund të shtyheni me diçka që është diskutim para përfundimit të diskutimit.

Kryesuesi Labinot Halilaj : Faleminderit një minutë replikë z. Gashi pastaj zonja. Kukaj, z. Sinani.

Petrë Gashi: Nuk e thash kryetar për komisionin, por e thash për neve për të marrë vendimin. Nëse doni veç me e kalu d.m.th Arsyeja e kësaj kohe është që unë me dit se për çka po votoj. Unë nuk e kam një raport të qartë për me arsyetu. Kjo është puna e arsyetimit sepse gjithnjë po themi që duhet mu ba zgjidhje njerëzve në Drenas. Mirëpo nuk mund pa u bërë unik me dit qysh kanë shkuar procedurat. Unë si anëtar i Kuvendit po kërkoj kohë deri në seancën e ardhshme dhe besoj që nuk është vonë. Nëse doni që të votohet se ju i keni votat atëherë votojeni, kurse ne nuk mund ta mbështesim këtë projekt propozim.

Kryesuesi Labinot Halilaj : Fjalën e ka Arsim Haxhiu Drejtori, mandej zoj. Kukaj .

Arsim Haxhiu; Të nderuar vetëm një sqarim të pyetjes që u bë pak më herët. Komisioni ka raportin komplet me vendimet me krejt dhe pas kësaj procedure vendimet që do të merrni

praktikisht emrat që i keni në propozim vendim, ka kohë një muaj 30 ditë afat të ankesës në Ministrinë e Planifikimit dhe Mjedisit Hapsinor dhe pas një muaj dite bëhet nënshkrimi i kontratës së plotë me këta. D.m.th nëse ka të pakënaqun është ankesë e shkallës së dytë sipas ligjit, këta anëtarët e komisionit janë mare më shumë me këtë çështje.

Sabrie Kukaj, Faktikisht krejt po thojnë se raporti u dashtë me kanë edhe koka. Unë nuk po pajtona me verifikua punën e këtyre se u këna dha besimin dhe tash me diskutu a kanë bërë mirë a keq, Na i këna votu. Por një raport të punës po e me fol mbi bazë të raportit, por ama unë nuk pajtoj që një kolegu ktu me i votu me i shku mbrapa se çka ka ba se është jo besim pastaj. Po raporti duhet me pru dhe mbi raportin këna çka ka me fol, se me kontrollu kolegët që ua këna dhanë besimin nuk po e shoh të arsyeshme.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj; Nëse ne kërkojmë një komision siç po e thotë mësuesja, na duhet edhe një komision tjetër me hetue ata mirë. E në një farë mënyre kjo është humor. Zoti Sinani e ka fjalën.

Petrit Sinani; Është e vërtetë se pavarësisht se jam i opozitës apo i pozitës mendoj se secili ka me dhanë atë kontributin e vet, kur diçka është një gjë e ndishme. Unë mendoj se komisioni që e këna përzgjedh ka bërë një punë të jashtëzakonshme dhe një punë ku askush normalisht nga ne nuk duhet pas dyshime prej neve. Mirëpo mos të harrojmë ky komision ka pas të bëjë me kategorinë më të ndishme, me kategorinë sociale d.m.th puna e tyre ka qenë e vështirë. Këta tre anëtarë unë e kuptoj që s'kanë qenë vetëm... ne këtu apsolutisht nuk kemi qëllim me paragjyku. Komisioni apslitisht ka bërë punë shkëlqyeshme. Unë e lexova pak më herët raportin rreth 5-6 faqe është hartuar mbi kriteret dhe në bazë të ligjit i kanë zbatuar. Ky komision nuk është vetëm prej tre anëtarëve të Kuvendit Komunal por ka pasur edhe anëtarë të tjerë, të cilë kanë qenë në përbërje. Kam parë në fb ca foto dhe vërtetë kanë bërë goxha punë, por normalisht raporti duhet me qenë këtu në kuvend dhe nuk është ndonjë raport voluminoz qe me ardh për 5 minuta mund ta kemi përpara. Por unë desh të them se ky komision e ka kryer punën e vet dhe ndoshta nuk keni nevojë me e pa fare raportin kështu që votojeni dhe të vazhdojmë me procedurat e tjera.

Vehbi Berisha, Po pajtoj me kërkesën e Sokolit që duhet me iu bashkangjit raporti. Mua më erdhi mirë që tek pika 2 ka persona që kanë bërë zgjidhje dhe kjo është një e arritur. Komisionin e përgëzoj. Unë kam pasur rastin ta takoj Naimin Gjelin, i cili tha: "Hiç lehtë se këna pas" sepse kan pas të bëjnë me kategorinë më ndishme. Ajo çka dua më thënë, Nexhi e përmendi se ka njerëz që vozitin kerre 20 mijë euro. Po kallxona vlla me emra dhe që këtu këna të drejtë me e heq, se ska guximin ai me na kallxu... kurrkush nuk ja ndal këtij kuvendi me ja përmirësu. Na jemi Kuvendi, organi legjislativ që me e ndrru qitu për qitu. Na nuk kemi nevojë me u frigu prej kurrkujt...Po Nexhi tha, kallxona pra kush.

Beqir Kiçina; Sa ju përket pyetjeve me parafolësit duke filluar nga anëtari i Kuvendit, Sokoli Bylykbashi, me të cilin u pajtuam. Materiali ka ardhur kështu që qëndron ajo si vrejte, por nuk pajtohem me disa anëtarë të cilët dhanë vërejtje dhe rekomandime mund mos mu pajtu me z.

Nexhmedin Balën që tha paga e arsimit nuk di sesi e formuloi, por unë vetëm e mora si shembull që edhe nëse ka një pagë në arsim dihet se ka shumë familje që kanë fëmijë me zhvillim të kufizuar dhe nuk do të thotë që ka mundësi. Sekretaria e solli raportin dhe unë nuk mund ta pranoj që të hidhet puna poshtë me pyetje e kërkesa për tu rikthyer e për të krijuar komision tjetër ...ndërhyrje në fjalën e tij.

Krysues Labinot Halilaj : Fjalën e merr z. Bylykbashi.

Sokol Bylykbashi; Mirë që na u dha raporti por kjo prap nuk na e plotëson atë çka unë kërkoja në fillim. Kjo nuk mund të lexohet për pak minuta por do kohë në mënyrë që ne të japim qëndrimin tonë tuj u bazu në raport. Po du me thanë tek pika 7 e raportit s'po du me citu emrin por thuhet se anëtarët e komisionit kanë shkuar në fshat për verifikim dhe atje u kanë thënë se jeton në Drenas dhe nuk ka asnjë informacion tjetër. Është fjala për një person që po i vazhdohet kontrata edhe për dy vjet. Për çka fola më lart, kur e ke raportin ti ke me diskutu dhe me pa seriozitetin dhe punën që kanë ba. Unë nuk dyshoj që këta nuk kanë patur qëllimin e mire por nuk më duket serioze. Nuk mundesh me than në raport nuk kemi marrë informacione pavarësisht për personin dhe pastaj i vazhdon kontratën. Për çka po flasim na? Kjo nuk është punë serioze. Unë e di që edhe me pas informata të hollësishme nuk mundesh me i përfshi në raport, por përmenden filan dokument e tjera dhe ne mund me i besu kur ti i përmend. Kjo tregon se nuk është bërë një punë serioze. Respekt për Beqën dhe ata që kanë punuar edhe pse është një punë shumë e vështirë, s'më duket serioze.

Beqir Kiçina; Sokol edhe para se me të ardh materiali ti paragjykoje. Ma ke përmendur është filani në listë... krijohet debat ... unë thash që u lakua emri i këtij zotëris, kurrëgjë nuk thash. Unë po të them ; Komisioni ka dal në terren, i kemi pas në dispozicion mjetet e komunës për me dal në terren , jemi dal kemi verifiku. Ne nuk e kemi gjet në banesë personin dhe nuk e dimë se ku ka qenë, kemi shkuar më shumë se një herë, punë e tij dhe kemi vazhduar. Ne nuk mund ti heqim dikujt të drejtën e banimit por kur e kemi marrë në telefon ka thënë nuk muj më nejt në atë banesë, ma ka liru vllau një pjesë të shtëpisë dhe në rregull është me të. Unë muj me thënë se ne si komision e kemi ba punën, aq sa kemi dit veç komisioni ka vepruar aq sa na ka lejuar brenda udhëzimeve dhe ligjeve pa paragjykuar kërkënd.

Sokol Bylykbashi; Desha pak me repliku me kolegun Petritin se na ka akuzu se pa asnjë bazë e kemi refuzu projektligjin dhe nuk kemi me votu. Na së pari kemi kërku raport dhe pa raport s'mund me diskutu e lëre me votu. Ne këna kërku që të paktën të kthehet në pikën zero. Tani na ka ardh raporti dhe prap mendoj se nuk është i kompletum. Këtu janë 7 emra dhe 15 përfitues kurse realisht janë 50 përfitues . Ku janë edhe 35 përfitues të tjerët në raport

Petrit Sinani; Nuk është mirë që ne si anëtarë të Kuvendit me jetu me paragjykime dhe nuk po e kuptoj këtë punë. Jo s'ka ardhur raporti, vjen raporti jo se s'kemi kohë me e lexu. Pastaj thua pika 7. Për një çështje kaq të ndjeshme me pas kaq shumë paragjykime pom çuditni sinqerisht po

ju thamë e pash edhe ne komitet për politik dhe financa pa asnjë bazë janë shku e kanë votu kundër , poti jepe arsyen.

Burim Bujupi , Deshta me repliku te kolegun Petritin se po thotë pa asëni bazë e kena refuzua, pa raport normal qe nuk votohet ne kemi kerku qe edhe njeher meu kthy ne piken 0. Raporti pom doket qe nuk është i kompletuar ktu i kemi vetëm 7, emra, realisht 15, emra i kem qe i kanë vizitu 15, familje, a ja nda dmth përfitues 50 familje , ku janë edhe për 35, familje tjera raporti.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj; I mbyllim diskutimet edhe për këtë pikë dhe kalojmë në votim; votojmë po, **23 Për, 4 Kundër 2 Abstenime.**

Kalojmë në pikën 5. Propozim Vendim për lëshimin në shfrytëzim afatgjatë të parcelës në ngastrën kadastrale në Komoran për ndërtimin e një objekti në shfrytëzim nga ana e Komunitetit. Zoti Hajdari një sqarim shkurt ju lutem.

Drejtori i Drejtorisë për Gjedozi Milaim Hajdari , Para vetes keni dy vendim propozime që kanë të bëjnë me dhënien afatgjat të pronës komunale për shfrytëzim për komunitetin. Kemi propozim vendim për dhënien ne shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale të Komunës së Drenasit për ndërtimin e një shtëpie për aktivitete të fshatit Komoran në territorin e Komunës së Drenasit. Propozimi është për zonën kadastrale në Komoran në pjesën e ngastrës kad. Nr.P-70314035-00320-1 me kulturë kullos e klasës 4, me sipërfaqe prej S=0.04 Ha ne zonën kadastrale në Komoran, zonë kadastrale në Komunën e Drenasit. Ju ftoi ta votoni këtë propozim vendim.

Vehbi Berisha; Natyrisht se vota ime është Për këtë pik të rendit të ditës , sepse kjo është në të mirë të qytetarëve dhe shfrytëzohet prej banorëve prej zonave ku kanë ardhë të cekura ne këtë propozim vendim. Mirëpo unë edhe ktyne banoreve te cilët janë mbrapa nesh nga lagjja Janova ja bëra me dije, qe ta mbajmë këtë standard dhe me ja bërë me dije çdo qytetari, pasi qe është situata në të mirën e qytetarëve ne jemi të obliguar me ia dhënë dhe me ia aprovuar këtë propozim vendim.

Kryetari i Komun Ramiz Lladrovci; Kjo që thotë Berisha vlen për të gjithë. Nuk mund të ndërtojë kurrkush në pronën e komunës dhe jo vetëm, por edhe në pronën private nëse nuk pajisen me dokumente do të pezullohen dhe deri një muaj pritet deri sa të plotësojë dokumentat. Në rastin e Komoranit, qoftë të Kishnarekës, qoftë të Korroticës, kushdo që shkel legjislacionin, kudo qoftë do të procedohet ligjërisht. Nuk ka edhe po ta japim edhe s'të takon. Nuk të takon. Herën tjetër e vazhdojmë me ligj dhe çdo gjë bëjmë përmes ligjit.

Sabrie Kukaj : Faktikisht ne ju kemi dal ne ndihmë të gjithë qytetareve qe kanë dashtë me ndërtua objekte për komunitet. Inspeksioni e ka ndërpre punën derisa të merret vendimi. Është mirë meja jap lejen.

Drejtori i Gjeodezis Milaim Hajdari: Ajo qe vlen te theksohet se qytetaret e lagjes Korroticë lagjes Janova është kufini zonës kadastrale qe i takon zonës kadastrale Sankoc. Komuna ka shpreh gadishmerin që ta bëj këtë propozim vendim meja jap në shfrytëzim, ndërkohë që për

shkak të fund vitit dhe motit atmosferik banorët kanë insistua me nis objektin gjithmonë duke pasur parasysh që kërkesat gjinden ne Komunë dhe Komuna do të hec me procedura. Ndërkohë ka arëdhë një ankesë e një pale , ne e kem obligim qe çdo ankesë qe Vjenë ne drejtorin e inspeksionit me dal me shqyrtua ,ne momentin kur dalin inspektorat ne teren , Ligji i ndërtimit i trajton te gjitha objektet njëjtë. Inspektorat kanë jap urdhrin për ndërprerje të punimeve dhe si gjdo objektiv në bazë ligjit të ndërtimit i jep 30 ditë afat meu pais me leje domosdoshmërisht janë te obliguar edhe Komuniteti i Janovë ve me respektua këtë. Ajo qe un e kisha sugjerua që edhe herëve tjera edhe përmes juve kur ka kërkesa të tilla është mirë qe komuniteti së pari të gjejë gjuhë të përbashkët mes veti por jo me e vendos neve poshtë si institucion lajthitje , se ne nuk jem asgjë kundër palës. Edhe diçka këtu është me rëndësi prona është shoqërore komunale , gjeodet janë dal dhe kanë vërtetu qe nuk i pengon. Un besoj qe duhet te përkrahët.

z. Bylykbashi: Komuna ekziston për një arsye mej përmbush nevojat e Qytetarëve. Ne e kemi për obligim me ju dhanë prona dhe besoi se të gjithë jemi me iu dhënë prona .Ajo qe du me than un jam i lumtur qe këta kanë arrit mej formu fondet . Qytetaret duhet te vetëdisohe qe të respektonin ligjin dhe disa procedura përndryshe nuk mundemi me u bë Komunë e as Shtet.

Kryetari Ramiz Lladrovci: Prona i jepet në shfrytëzim afatgjatë , por ne rast se iu nevojitet për interes të përgjithshëm ju merret toka me gjithë objekt dhe nuk kompenson komuna. Në rast se votohet ju duhet me i ndjek procedurat tjera, janë disa procedura tjera , pasi ta marrim ligjshmërinë nga MAPL-ja duhet me kërkuar me ndërruar destinimin e pronës, nga bujqësore ose kullosë në ndërtim. I keni edhe disa procedura tjera dhe disa pagesa të vogla që duhet me i bërë.

Znj. Gjylani: Sqaroi se është bërë gabim teknik tek propozimi i dytë se në vend të fshatit Komoran është dashtë me u shkruar Sankoc.

Kryesuesi Labinot Halilaj: Hodhi në votim pikën e pestë: **27 Për, 0 Kundërt, 0 Abstenim.**
Propozim Vendim për lëshimin në shfrytëzim afatgjatë të parcelës në ngastrën kadastrale në Komoran për ndërtimin e një objekti në shfrytëzim nga ana e Komunitetit

Pika 6. Propozim Vendim për lëshimin në shfrytëzim afatgjatë të parcelës në ngastrën kadastrale në Sankoc për ndërtimin e një objekti në shfrytëzim nga ana e Komunitetit.

Pasi nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime **Kryesuesi Labinot Halilaj :** hodhi në votim këtë rend dite: **24 –Për, 1- Kundër, 1-Abstenim**

Kryesuesi Labinot Halilaj: hapi diskutimin për pikën shtatë: **Propozim Vendim për harmonizimin dhe transferin e mjeteve për paga.**

Pas sqarimit te arsyetimit te drejtorit te Financave kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit: për votuan **25, 0 kundër, 0 abstenim.**

Kryesuesi Labinot Halilaj: hapi diskutimin për pikën e radhës: **Propozim Rregullore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2020.**

Nexhmie Korrumeli: Sqaroi se ky raport i vlerësimit është bërë në bazë të një komisionit vlerësues, komision kompetent që është bërë nga ministria e financave e respektivisht nga departamenti i tatimit në pronë prej eksperteve të fushave përkatëse, në vitin e kaluar ka qenë për toka bujqësore ndërsa për vitin 2020 tani kanë hyrë edhe pronat rezidenciale ku bëjnë pjesë shtëpitë, garazha, banesa e objekte tjera rezidenciale që janë objekte ndihmëse që duhet të përputhen me zonat e vlerësimit të parcelave të tokës. Vitin e kaluar kemi thënë se brenda 5 viteve do të bëhet vlerësimi i tatimit në pronë. Këtë vit është pronat rezidenciale ndërsa në vitin e ardhshëm të bëhet edhe pronat komerciale dhe ato industriale.

Vehbi Berisha: Në bazë të këtij vlerësimi a do të zhblllokohen faturat në bazë të vlerësimit që kan ardhë deri me tani vlerësimi është bërë po kur ka ardhur puna për me paguar kemi paguar vetëm për tatimin në pronë për shtëpia nuk është edhe për këto pjesë tjera pavarësisht vlerësimit që është bërë.

Nexhmie Korrumeli: Tani prapë do të vijë fatura njëjtë, do të njoftoheni me vlerësim. Mirëpo me një vendim që është dal nga Ministria e Financave i nënshkruar nga ministri Z.Hamza e keni pasur në material është edhe për vitin 2020 të gjitha pronat bujqësore do të lirohen nga tatimi në pronë. Normat tatimore do të mbeten si vitin e kaluar dmth janë minimale.

Kryesuesi Labinot Halilaj: Hodhi në votim këtë pikë rend dite : 26 Për, 1 Kundërt, 1 Abstonim.

Kryesuesi Labinot Halilaj: hapi diskutimin për piken e radhës Propozim Vendim për mbështetje financiare qyteteve të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në Republikën e Shqipërisë.

Shyqri Bublaku: Të gjithë jemi të njoftuar me gjendjen e Republikës së Shqipërisë dhe me gjendjen e qytetarëve pas fatkeqësisë së tërmetit të ndodhur. Ne si Kuvend Komunal duke i shqyrtuar dhe duke i analizuar mundësitë financiare kemi bërë një propozim vendim prej 10.000€ kesh për qytetarët që janë të prekur nga tërmeti. Kjo është një kërkesë e arsyeshme. Shuma e mbetjeve do të nxirret nga kategoria e subvencioneve nuk dot preken mbetjet e tjera.

Kryesuesi Labinot Halilaj : Po z.Sinani, z.Kiqina

Petrit Sinani: Unë kisha than që edhe ne Asambleistat të ju bashkangjitemi që pagën e asambleistave të këtij muaji e jap për viktimat në Shqipëri.

Beqir Kiqina: Nuk e di sa është adekuate pyetja që do të bëj, është me përgëzua vendimin që ka ardhur. Fondet a i drejtohen transfer drejtpërdrejt Qeveris apo një Organizatë Joqeveritare.

Shyqri Bublaku Ne si Institucion nuk guxojmë me vendos pare ne gjyrollogari tjera përpos ato Shtetërore dmth vendosen ne gjyrollogari që i cakton Republika e Shqipërisë.

Sokol Bylykbashi: Unë kam kërkuar para disa dite që të mbahet edhe një mbledhje urgjente për arsye që kam menduar se sa më parë që ndajmë mjete financiare është më mirë kur ka kriza të

tilla si ka ndodhur ne Shqipëri. Qytetarët kanë ndihmuar mjaftë edhe ne si lëvizje krejt qendrat kemi qar këndvoj të ndryshme .

Kryesuesi Labinot Halilaj: Hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës e cila u votua ne mënyrë anonime.


Kryesuesi Labinot Halilaj: Kemi edhe piken e 10 Propozim Vendim për ndryshim të anëtarëve të KKSB-së. Ndryshohen këta emra z. Driton Morina qe ka qen natarë i KKSB-së zëvendësohet me znj. Feime Bajrami nga Stacionit Policor në Drenas, znj. Rinora Zymeri zëvendësohet me z.Arben Shala koordinator i KKSB-së, z.Alban Sopi zëvendësohet me z.Meriton Sopi nga Komuniteti Katolik , z.Tafil Halilaj zëvendësohet me një kur të emërohet një Drejtor i Arsimit. z. Milaim Musliu zëvendësohet me z. Besfort Kruma FSK , znj. Taibe Mulaj zëvendësohet me z. Behxhet Binaku - Hendikos , znj. Rina Shabani zëvendësohet me Znj. Donika Zogu KVRL, z. Armend Garaj shtohet nga KLSP-ja Komoran.


Kryesuesi Labinot Halilaj: Hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: 26 Për , 0 Kundërt , 0 Abstenim .

Kalojmë te Pika e 11. Të ndryshme nuk ka diskutime, pastaj mbledhjen e deklaroi të mbyllur.

Mbledhja Përfundoi në ora 12⁰⁰:26⁰⁰

Procesmbajtëse:


Zahrie Podrimqaku-Subashi

 
Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj